

FJALA E DEPUTETIT FLORENC SPAHO

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Jam i nderuar që sot në fjalën time do të fokusohem në një çështje kaq të rëndësishme, që na përket të gjithëve, siç është shëndetësia. Sistemi ynë shëndetësor, për hir të së vërtetës, ka pësuar ndryshime rrënjësore vitet e fundit, dhe kjo gjë është lehtësisht e faktueshme. Pa diskutim që kemi qenë edhe në situata aspak të favorshme dhe emergjente, si tërmeti i 26 nëntorit dhe më vonë pandemia, por kemi pasur gjithmonë vullnetin e mirë për të bërë gjithmonë e më shumë dhe, përtej të gjitha vështirësive të lartpërmendura, ne nuk jemi ndalur në ndërtimin e disa spitaleve, ku mund të përmend edhe patologjinë e Elbasanit apo zinxhirin e qendrave shëndetësore, jo pak, por 300 qendra shëndetësore në të gjithë Shqipërinë.

Duke qenë se përmenda spitalin e Elbasanit, dhe nga disa kolegë këtu u përmend edhe pandemia, jam dëshmitar, sepse kam punuar për më shumë se 11 vjet në spitalin e Elbasanit dhe imagjiloni sikur pandemia të kishte rënë vite më parë dhe dikush të diagnostikohej nga Covid-19 dhe të kërkonte një ekzaminim shtesë si skaneri, në një kohë kur skaneri për të diagnostikuar në kohë një sëmundje pulmonare nuk ekzistonte. Imagjiloni se çfarë ngarkese do të kishte ndodhur në QSUT nga i gjithë rajoni i Elbasanit, por dhe më gjerë. Në fakt, lista e investimeve është relativisht e gjatë dhe nuk mjafton koha fizike për t'i përmendur të gjitha. Nevojat për përmirësimin e investimeve apo shërbimeve janë gjithnjë të pranishme, ndaj lind si domosdoshmëri marrja e kësaj huaje nga Banka Ndërkombëtare për të cilin bën fjalë edhe projektligji, ku do të ndalemi më gjerësisht.

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin shtesë për projektin

“Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë”. Përmes këtij projektligji synohet të arrihen shërbime shëndetësore sa më të modernizuara, si dhe rindërtimi i sa më shumë objekteve të shërbimit shëndetësor të dëmtuara nga tërmeti, po ashtu synohet forcimi i kapaciteteve të menaxhimit të sektorit të spitaleve publike për sa i përket përditësimit të masterplanit ekzistues të spitaleve publike, rishikimi i kuadrit rregullator ligjor dhe administrativ të spitaleve për përmirësimin e menaxhimit spitalor të shërbimeve dhe rekomandimeve spitalore.

Disa pika me rëndësi janë edhe përditësimi i udhëzimeve klinike dhe protokolleve për sëmundjet kronike prioritare, krijimi i llogarive kombëtare të shëndetit, po ashtu zbatimi i mekanizmave për angazhimin e qytetarëve për të rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën në ofrimin e shërbimeve spitalore, sensibilizimi dhe informimi i publikut për reformat e ndërmarra në fushën e shëndetësisë, si dhe hartimi i një strategjie gjinore dhe mbështetjen e aktiviteteve ndërgjegjësuese, që ka në fokus trajtimin e kancerit të gjirit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe infrastruktura mbështetëse e shërbimeve spitalore, duke synuar që të ofrohet një fushë e re shërbimesh në objektet rajonale dhe bashkiake, pa lënë mënjanë rehabilitimin e infrastrukturës dhe pajisjeve mjekësore, si dhe hartimin e një strategjie për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore në sektorin e shëndetit publik dhe trajnimin e personelit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në spitale apo agjenci publike.

Informacioni shëndetësor-spitalor duhet të jepet në një mënyrë me të strukturuar, duke përfshirë zhvillimin e një masterplani dhe marrëveshjeje institucionale për aktivitetin e shëndetit elektronik. Gjithçka që përmenda më lart është në përputhje me atë që në programin e qeverisjes i kushtohet një vend i veçantë strategjisë për shëndetin one health, i cili, mes të gjitha nismave konkrete, aspirojnë drejt një shërbimi shëndetësor të modernizuar dhe sa më pranë qytetarëve. Kjo strategji është parë përmes një shtrirjeje të gjerë në çdo hallkë, duke e integruar brenda një kuadri të gjerë politikash si ato ekonomike, financiare, teknologjike, sociale apo politikën e jashtme. Shëndeti është prioritar dhe domosdoshmërisht pjesë e të gjitha politikave për të arritur jo vetëm një përmirësim rrënjësor, por edhe një qëndrueshmëri në shërbim.

Përmes miratimit të këtij projektvendimi, marrjes së kësaj huaje ndezim dritën e gjelbër për gjithçka që përmenda më lart. Projektligji synon të mbështesë 2 nga 17 objektivat e agjendës 2030 “Për zhvillim të qëndrueshëm”, objektivin 3 “Sigurim i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe” dhe objektivin 9, “Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit”. Kështu, mund të kalojmë në atë që synohet edhe në strategjinë e shëndetësisë dhe për një mbulim shëndetësor universal që t’i përfshijë të gjitha grupmoshat dhe të gjitha kategoritë.

Ndër të tjera, projektligji ka si objektiv specifik fuqizimin e sistemit të integruar, shëndetin digjital, rritjen e rolit të qytetarit në aksesin dhe përdorimin e shërbimeve digjitale të kujdesit shëndetësor, infrastrukturës dhe teknologjisë shëndetësore; fuqizimin e informacionit shëndetësor si nevojë për vendimmarrje në përmirësimin e shëndetit dhe të mirëqenies së qytetarëve; fuqizimin e kapaciteteve për kërkimin shkencor dhe publikimin e evidencave shkencore. U ndala, në fakt, në mënyrë të detajuar, sepse janë çështje që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën dhe cilësinë e jetës së qytetarëve.

Projekti financohet në masën 100% nga Banka Botërore dhe shuma që do të merret është, siç e tha edhe ministrja e nderuar, 25 milionë euro, që, pa diskutim, është një shumë e konsiderueshme, e cila sinkronizohet edhe me buxhetin e shtetit për investime në shëndetësi apo për grante të ndryshme. Në fakt, më ka ardhur keq që në komision disa kolegë të opozitës kanë diskutuar dhe mendojnë se kjo hua është e pamjaftueshme për të bërë gjithçka. Unë thashë, apo edhe ministrja e nderuar, se nuk mund të bëhet asgjë e madhe ose, edhe në qoftë se merret, ka një kosto të madhe për buxhetin e shtetit.

Në fakt, ndoshta kolegët e opozitës kanë harruar një hua që kanë marrë prej 97 milionë eurosh, nga viti 2005 deri në vitin 2013, për të cilën nuk dihet se çfarë është bërë, nuk ka asnjë projekt të dukshëm, ashtu siç nuk dihet, në fakt, se çfarë është bërë edhe me buxhetin e shtetit, sepse të gjithë kemi qenë dëshmitarë dhe ky është një fakt se, të shkoje më përpara në spitalet tona, ishte sikur shkoje nëpër burgjet e komunizmit, për të mos përmendur më tej edhe sallat operative, ku instrumentet operative ishin të ndryshkura dhe patjetër që personeli mjekësor haste shumë vështirësi për të punuar me to. Kjo hua, patjetër, nuk mund të mbulojë të gjitha

nevojat tona në shëndetësi, por mund të bëhen edhe shumë investime të dukshme dhe të prekshme që mund të krijojnë edhe lehtësi në dhënien e shërbimit dhe, patjetër, personeli do të japë një shërbim edhe më cilësor, siç e meritojnë shqiptarët.

la vlen të ritheksoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji, duke i mëshuar fort faktit që përmes tij synohet të ngrihet sistemi shëndetësor, të modernizohet, të digjitalizohet, të jetë më i aksesueshëm dhe shumë më tepër funksional. Asgjë nuk ka vlerë pa shëndetin. Në çdo fushë të jetës, nëse nuk kemi shëndetin, të gjitha të tjerat duken të parëndësishme. Për të gjitha sa thashë më lart, dua të falënderoj pa fund qeverinë dhe Ministrinë e Shëndetësisë për vizionin dhe për politikën që ka ndërmarrë për shëndetin!

Dua të falënderoj, në mënyrë të veçantë, të gjithë stafin e palodhur të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili ka punuar në kushte të zakonshme dhe të jashtëzakonshme! E pa diskutim, në fund, por jo për nga rëndësia, dua të falënderoj mantel-bardhët, të cilët janë heronjtë tanë të përditshmërisë dhe janë heronjtë e shekullit! Faleminderit!